



Prishtinë: 30.06.2009

Kodi i ZRRE-së: V_200_2009

Nr. I Referencës: ZRRE/DMK_R_239_06_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_239_06_09;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2009 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Fetah Berisha “ DA VITA” (shifra e konsumatorit DPR – 90021145) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij rekomandimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të datës 06.05.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 23.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 16.03.2001 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kane hequr njehsorin elektrik nr. 020788 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 17677545.

Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit i datës 16.03.2001

- Me datë 20.06.2008 zyrtarët e autorizuar të shërbimit të kontrollës të KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të kontrollimit të pikës matëse, gjatë kontrollimit të pikës matëse kanë kërkuar që njehsori elektrik duhet të dërgohet në kalibrim për shkak të dyshimit në vula (blloba) shtetërore.

Provë: Procesi i KEK-ut nr. 0116258 i datës 20.06.2008

- Me datë 20.08.2008 zyrtarët e autorizuar e KEK-ut kanë hequr njehsorin nr. 17677545 dhe kanë vendosur njehsorin ri nr. 4378128.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit i KEK-ut nr. 005205
- Me datë 01.12.2008 Qendra e Kalibrimit gjatë kontrollimit detal të njehsorit nr. 17677545 ka konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllomb) shtetërore i ka të manipuluar dhe se numëruesi i njehsorit i manipuluar; ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numërues.
Provë: Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 25/27 të datës 27.11.2008
- Me datë 16.03.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR09HP07409 në shumë prej 11,588.12 €.
Provë: Fatura DPR09HP07409 të datës 16.03.2009
- Me datë 25.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 23.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në proceset e kontrollës dhe procesin e kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 21.04.2009
- Me datë 06.05.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Me datë 24.03.2009 personat zyrtarë të autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori dhe kanë konstatuar se gjendja e njehsori është reale.
Provë: Procesverbali nr. 182496 të datës 24.03.2009
- ✓ Sipas procesverbalit të qendrës së kalibrimit nr. 25/27 të datës 27.11.2008 është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar dhe se numëruesi i manipuluar ka gjurmë kthimi mbrapa të numrave në numëror.
Provë: Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 25/27 të datës 27.11.2008
- ✓ Sipas rrjedhjes së energjisë aktive shihet si me njehsor të vjetër ashtu edhe me njehsor të ri shpenzimi i konsumatorit është zero, që do të thotë se nuk shpenzim të energjisë elektrike. Shihet se prej periudhës 11/2003 e tutje njehsori i konsumatorit nuk ka regjistruar asnjë kilovat të shpenzuar.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Për periudhën të cilën është edhe objekt shqyrtimi ankesa shihet se konsumatori nuk ka asnjë shpenzim të energjisë elektrike, veç se gjatë asaj periudhe është fatura me tarifën fikse dhe taksën për emetuesin publik.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së,

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

- Shkarkoj konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike DPR09HP07409 në shumë prej 11,588.12 €.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar